



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 909124  
Data. 22.08.24



Prishtinë, 07 gusht 2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_2229\_2024

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15, Nenin 25, Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084); Dispozitat e Nenit 23, Paragrafi 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L – 085); Dispozitat e Nenit 8, pika 8.1.2 të Rregullave të Tregut; Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT SH.A.), të datës 05.06.2023, nr. prot. 300/23, për shqyrtim dhe aprovim të Procedurës së Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar, në seancën e mbajtur me datë 07 gusht 2024, nxori këtë:

## V E N D I M

### I. APROVOHET - Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar.

## A r s y e t i m

- Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme ZRRE) më datë 05.06.2023 ka pranuar nga Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOSTT SH.A., (në tekstin e mëtejme: KOSTT), kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të Procedurës së Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar.
- Duke pasur parasysh se në të njëjtën kohë KOSTT ka inicuar edhe ndryshime në Rregullat e Tregut, atëherë procedura ka mbetur në pritje dhe, më datë 24.01.2024, pas kërkesës së Rregullatorit për sqarime, KOSTT edhe njëherë përmes emailit rikonfirmoi se ndryshimet në Rregullat e Tregut nuk implikojnë ndryshime në procedurat e dërguara më herët në ZRRE për aprovim dhe ka kërkuar nga ZRRE shqyrtimin dhe aprovimin e kësaj procedure.
- Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar është përpiluar në përputhje me paragrafin 8.1.2 të Rregullave të Tregut që janë përgatitur në përputhje me Nenin 23 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 05/L -085 për Energjinë Elektrike.
- ZRRE, në përputhje me Nenin 27 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, me datë 7 shkurt 2024, ka vendosur në konsultim publik dokumentin, Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar, duke ju ofruar mundësinë të gjitha palëve të interesit të ofrojnë komentet e tyre brenda 15 ditëve nga data e publikimit.
- Duke pasur parasysh çështjet e ngritura në fazën e konsultimit publik, ZRRE ka ftuar në takim KOSTT-in për të arsyetuar ndryshimet në dokument.



- o Ndër çështjet e ngritura në këtë takim kanë qenë lidhur me pagesat për tarifën tjera të parashikuara në garancion, lidhur me nivelin minimal të vlerës së garancionit si dhe çështja e mundësisë së bankave në Kosovë për ta ofruar këtë lloj dhe nivel të garancionit financiar.
- o KOSTT ka dhënë sqarimet e duhura lidhur me çështjet e ngritura në fazën e konsultimit publik, duke përfshirë edhe konfirmimin përmes emailit lidhur me mundësinë e bankave në Kosovë për ta ofruar këtë lloj dhe nivel të garancionit financiar të përshkruar në procedurë.
- o ZRRE, pas analizimit dhe vlerësimit të Procedurës së Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar dhe pas përfshirjes së komenteve ka vlerësuar se i njëjti është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe i harmonizuar me Rregullat e Tregut.
- o Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe shqyrtimit të Procedurës së Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet:

- Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar.


**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Lutfije Dervishi, Anëtare

  
Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

  
Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi i dërgohet:

- KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji